
Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit **“Suolo e Salute”**
për Rajonin e Campania-s
Workshop: **“Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV”**
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

AGRIKULTURA BIOLOGJIKE

**Praktika dhe eksperiencia Italiane
në zbatimin e Rregulloreve për Agrikulturën Biologjike
në Komunitetin Evropian.**

**Rregulloret KE nr. 834/07 – KE nr. 889/08
për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme Agrikulturale**

Certifikimi

Entet e kontrollit

Kontrolli i aktivitetit

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit **“Suolo e Salute”**
për Rajonin e Campania-s
Workshop: **“Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV”**
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Kodiku i Përkufizimeve Ushqimore

Agrikultura Biologjike është sistemi i integruar i prodhimit bujqësor, vegjetal dhe shtazor, që mënjanon ndikimin e faktorëve të jashtëm në aktivitetet bujqësor të privileguara në praktika dhe trajtime, duke angazhuar metoda biologjike në kulturat bujqësore në vend të përbërësve të sintetizuar kimikë dhe që priret drejt përshtatjes së sistemit të prodhimit me kushtet lokale.

Agrikultura Biologjike promovon përmirësimin e sistemit ekologjik, në veçanti biodiversitetin, ciklet biologjike dhe aktivitetin biologjik të Tokës.

Rregullore KE nr. 834/07

Agrikultura Biologjike është një sistem global i menaxhimit të sipërmarrjes bujqësore dhe prodhimit agrorshqimor bazuar në ndërveprimin e praktikave më të mira ambientaliste, mbi një nivel të lartë biodiversiteti, ruajtëse dhe mbrojtëse e burimeve natyrore dhe zbatuese e kriterëve rigoroze në çështje të mirëqenies së kafshëve për përfitimin e një produkti të përshtatshëm për preferencat e disa konsumatorëve për produkte të përfituara me përbërës dhe procese natyrore.

Pikat themelore të Rregulloreve KE nr. 834/07 dhe nr. 889/08

Rregullorja KE nr. 834 e vitit 2007: është rregullorja themelore e lidhur me prodhimet biologjike dhe etiketimin e produkteve biologjike e cila shfuqizoi Rregulloren nr. 2092/91. Kjo rregullore ndiqet nga Rregullorja e aplikimeve nr. 889/2008 e cila përmban procedurat dhe stabilizon normat specifike lidhur me prodhimet biologjike, etiketimin dhe kontrollin e produkteve biologjike.

Rregullorja KE nr. 889/08 është e ndarë në 5 Tituj të strukturuar në 20 pjesë përbërëse me specifikat dhe përcaktimet përkatëse:

Titulli I	Dispozitat hyrëse
Titulli II	Normativat mbi prodhimin, konservimin, transformimin, ambalazhimin dhe magazinimin e produkteve
Titulli III	Etiketimi-Logimi, përshkrimi
Titulli IV	Kontrolli-kërkesat e kontrollit minimal, kërkesat e kontrollit specifik, mbikëqyrja
Titulli V	Përcjellja e informacionit, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Reg. KE nr. (834/07)

Kjo rregullore fokusohet në veçanti në Titullin II, konkretisht në normativat mbi prodhimin, konservimin, transformimin, ambalazhimin, transportimin dhe magazinimin e produkteve:

Kreu 1	Prodhimet vegjetale (bimore)
Kreu 2	Prodhime shtazore
Kreu 2 (nënkreu)	Kulturat ujore
Kreu 3	Produkte të konservuara dhe të transformuara
Kreu 3 (nënkreu)	Vreshtaria, normat specifike
Kreu 4	Grumbullimi, ambalazhimi, transportimi dhe magazinimi i produkteve
Kreu 5	Normativat e shndërrimit
Kreu 6	Normativat e prodhimeve të veçanta

20 Pjesët përbërëse të Rregullores KE nr. 889/2008:

Pjesa përbërëse I	Plehrat dhe përmirësuesit e tokës
Pjesa përbërëse II	Antiparazitët
Pjesa përbërëse III	Sipërfaqet minimale dhe karakteristikat e stafetës (ndryshimi i kulturave)
Pjesa përbërëse IV	Numri maksimal i kafshëve për hektar
Pjesa përbërëse V	Lënda bazë për ushqyerjen
Pjesa përbërëse VI	Shtesat ushqimore
Pjesa përbërëse VII	Produktet e pastrimit dhe dezinfektimit të ambienteve dhe impianteve
Pjesa përbërëse VIII	Produktet dhe substancat e përdorura në prodhimin e ushqimeve biologjike të transformuara
Pjesa përbërëse VIII (2)	Produktet dhe substancat e përdorura në vreshtari
Pjesa përbërëse IX	Përbërësit jo biologjikë me origjinë bujqësore
Pjesa përbërëse X	Speciet për të cilat farat ose zhardhokët për farëzim organik janë në dispozicion
Pjesa përbërëse XI	Logo-ja biologjike e BE-së
Pjesa përbërëse XII	Modeli (formati) i dokumentit arsyetues
Pjesa përbërëse XII (2)	Modeli (formati) i dokumentit arsyetues plotësues
Pjesa përbërëse XII (3)	Ilustrimi i modelit (formatit) të dokumentit arsyetues plotësues
Pjesa përbërëse XIII	Modeli i Deklaratës së shitjes-NO GMO
Pjesa përbërëse XIII (2)	Kushtet e kulturave ujore
Pjesa përbërëse XIII (3)	Të dhëna që duhen integruar në raportet vjetore
Pjesa përbërëse XIII (4)	Referimet me të dhënat që sigurohen nga Agrikultura
Pjesa përbërëse XIV	Tabela e pajtueshmërisë

Përmbajtja e Rregullores KE nr. 834/2007 dhe përcaktimet e zbatimit nga Rregullorja KE nr. 889/2008 janë në evolucion të vazhdueshëm prej modifikimeve dhe përfshirjes në to të rregulloreve të ndryshme Komunitare.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Në dt. 14.06.2018 u publikua Rregullorja KE 848 dt. 30.05.2018 e cila do të hyjë në fuqi dhe do të aplikohet nga dt. 01.01.2022 (për shkak të pandemisë Covid-19) dhe që shfuqizon Rregulloren KE 834/07.

Rregulloret

Rregullorja KE nr. 1235/2008:

Përmban procedurat e aplikimit të rregullores KE nr. 834/2007 të Këshillit lidhur me regjimin e importit të produkteve biologjike nga vendet e treta

Rregullorja KE nr. 710/2009:

Modifikon rregulloren KE nr. 889/2008 e cila i referohet procedurave të aplikimit të Rregullores KE nr. 834/2007 të Këshillit lidhur me shpjegimin e procedurave të aplikimit për prodhimet shtazore dhe algat detare të kulturave ujore biologjike.

Rregullorja nr. 271/2010:

Përmban modifikime të Rregullores KE nr. 889/2008 e cila i referohet procedurave të aplikimit të Rregullores KE nr. 834/2007 të Këshillit lidhur me logot e produkteve biologjike në Bashkimin Evropian.

Rregullorja KE nr. 203/2012:

Modifikon Rregulloren KE Nr. 889/2008 që përcakton procedurat për zbatimin e Rregullores KE nr. 834/2007 në përputhje me metodat e aplikimit për verën organike

Rregulloja KE nr. 392/2013:

Modifikon Rregulloren nr. 889/2008 që i referohet sistemit të kontrollit për prodhimet biologjike (nivele e rrezikut, inspektimet verifikuese etj)

Rregullorja KE nr. CE 354/2014:

Modifikon dhe ratifikon Rregulloren KE nr. 889/2008 lidhur me etiketimin e prodhimit të produkteve biologjike dhe kontrollin përkatës

Rregullorja KE nr. 836/2014 – 673/2016 – 2273/2017:

Modifikon Rregulloren KE nr. 889/2008 referuar procedurave të aplikimit të Rregullores KE nr. 834/2007 lidhur me prodhimet biologjike të etiketuar si produkte biologjike përsa i përket prodhimit biologjik, etiketimit dhe kontrollit.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Përfshirja e Rregulloreve të Komisionit Evropian për Agrikulturën Biologjike në Dekretet Ministrore të Qeverisë Italiane

Përmbajtja e Rregullores KE nr. 834/2007 dhe ndryshimet pasuese janë zbatuar/integruar nga Shteti Anëtar i Bashkimit Evropian, Italia, nëpërmjet dekretëve specifike ministrore, nga të cilat më të rëndësishme janë:

DM 18354/2009:

Dispozitat për zbatimin e Rregullores KE nr. 834/2007, nr. 89/2008, nr. 1235/2008 dhe ndryshimet pasuese në lidhje me prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike (*shfuqizuar nga DM 6793/2018*);

DM 16954/2010:

Kërkesat minimale për procedurat e marrjes së mostrës së produktit biologjik;

DM 18378/2012:

Dispozitat për zbatimin e Rreg. KE nr. 1235/2008, përcaktimin e metodave të zbatimit të Rreg. KE nr. 834/2007 të Këshillit referuar regjimit të importit të produkteve organike nga vendet e treta (*shfuqizuar nga Dekreti Ministror 8283/2018*);

DM 10071/2012:

Masat urgjente për përmirësimin e sistemit të kontrollit sikurse parashikon Neni 27, në vijim të Reg. KE nr. 834/2007 dhe rregulloret përkatëse të funksionimit të njësive përbërëse të sistemit të certifikimit dhe mënyrës së ndryshimit të entit certifikues.

DM 2049/2012:

Dispozitat për zbatimin e Rregullores aplikuese Nr. 426/11 për menaxhimin e automatizuar të informacionit rreth aktiviteteve që aplikojnë metoda organike në përputhje me nenin 28 të Rreg. KE nr. 834 të Këshillit të dt. 28 qershor 2007 dhe ndryshimet pasuese, në lidhje me prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, e cila shfuqizon Reg. (KEE) nr. 2092/91.

DM 18321/2012:

Dispozitat për menaxhimin e kompjuterizuar të programeve vjetore të prodhimit bimor, shtazor, ujqor, përgatitjen dhe importet e produkteve organike si edhe menaxhimin e kompjuterizuar të dokumentacionit mbështetës dhe të certifikatës së konformitetit sikurse parashikon Rregullorja KE nr. 834/2007 me ndryshimet pasuese apo shtesat;

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

DM 15992/2012:

Dispozitat për zbatimin e Rregullores Zbatuese (BE) nr.203/2012 të Komisionit që ndryshon Rregulloren KE nr. 889/2008 lidhur me procedurat e zbatimit të Rregullores KE nr. 834/2007 në linjë me metodat e aplikimit për prodhimin e verës organike (*shfuqizuar nga Dekreti i 8 majit 2018*)

DM 15962/2013:

Dispozitat për miratimin e listës së mospërputhjeve krahas masave përkatëse që organet e kontrollit duhet tu referohen për kontrollin e operatorëve sipas parashikimeve të Rregullores KE nr. 889/2008, ndryshuar nga Rreg. KE n. 392/2013

DM 26588/2013:

Procedurat për autorizimin e organeve të kontrollit si edhe të personelit të inspektimit lidhur me aktivitetet e kontrollit dhe certifikimin e prodhimeve agro-ushqimore.

DM 18096/2014:

Përcaktimi i kohës dhe metodave për menaxhimin e masave të miratuar nga organet e kontrollit ndaj operatorëve të sektorit të prodhimit organik pas verifikimit të jo-pajtueshmërisë, në zbatim të Nenit 7 të Dekretit Ministror të 20 Dhjetor 2013 nr. 15962.

DM 271/2015:

Krijimi i Regjistrat Kombëtar të Mbikëqyrjes

DM 3286/2016

Ndryshimet në Dekretin Ministror 18354 të 27 nëntorit 2009

DM 8283/2018:

Dispozitat për zbatimin e Rreg. KE nr. 1235/2008 referuar përcaktimit të metodave të zbatimit të Rreg. KE nr. 834/2007 të Këshillit në lidhje me regjimin e importit për produktet organike nga vendet e treta që shfuqizon Dekretin Ministror 18378, të 9 Gushtit 2012

Dekreti legjislativ nr. 20 datë 23.02.2018:

Dispozitat për harmonizimin dhe racionalizimin e legjislacionit të kontrolleve mbi prodhimin bujqësor dhe atij agro-ushqimor biologjik (*Shfuqizon Dekretin Legjislativ 220/1995*)

DM 8 maj 2018:

Disiplina e produkteve organike të vreshtarisë, në zbatim të nenit 20, të ligjit 238 dt. 12 dhjetor 2016, në respektim të: “Disiplina organike e kultivimit, prodhimit të vreshtarisë dhe e tregtisë së verës”.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

DM 6793/2018: (dhe ndryshimi pasues me Dekretin Ministror 3757/2020): Dispozitat për zbatimin e Rregulloreve KE nr. 834/2007 dhe nr. 889/2008 dhe ndryshimet apo shtesat pasuese, në lidhje me prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, *shfuqizimi i dekretit nr. 18354 të vitit 2009*

Informacioni specifik referuar parashikimeve normative të Bashkimit Evropian për Agrikulturën Biologjike

Fusha e zbatimit (neni 1 i Rregullores së KE. 834/2007):

Rreg. 834/07 zbatohet për produktet e mëposhtme:

- Produkte bujqësore të gjalla ose të papërpunuara
- Produkte bujqësore të transformuar (ushqim)
- Lënda bazë për ushqyerjen
- Farat dhe materiali për shumimin
- Majanë
- Produktet e akuakulturës
- Vera

Nuk zbatohet për:

- Ushqimin e kafshëve për lesh apo kafshë shtëpiake;
- Produktet nga gjuetia dhe peshkimi;
- Produkte tekstili dhe kozmetike.

Shënim: Për trajtimin kolektiv të struçëve, lepujve dhe kërmijve zbatohen rregulloret të veçanta të autorizuara nga Mipaافت (Ministria e Ushqimit Agrikultural, Politikave Pyjore dhe Turizmit)

KATEGORITË E OPERATORËVE BIOLOGJIKË

- I. **Prodhuesit** (e produkteve vegjetale, shtazore, bletarisë dhe akuakulturës)
- II. **Përgatitësit** (e lëndës bazë ushqimore, ushqimit, produkteve të vreshtarisë)
- III. **Importuesit**
- IV. **Grumbulluesit**

Një operator i vetëm mund të mbulojë një, disa ose të gjitha aktivitetet

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

KUSH DUHET TI NËNSHTROHET KONTROLLIT?

Të gjithë operatorët e zinxhirit të Prodhimit-Përgatitjes (ruajtja, transformimi, përfshirë therjen dhe prerjen e produkte shtazore, paketimi, konservimi, etiketimi)-Shpërndarjes si edhe çdo aktivitet që nënkontraktin një nga aktivitetet e zinxhirit të mësipërm duhet ti nënshtrohet kontrollit.

KUSH ËSHTË I PËRJASHTUAR NGA KONTROLLI?

Neni 28 i Rregullores së KE. 834/07

Janë të përjashtuara nga kontrolli vetëm ato subjekte të zinxhirit të cilat tregtojnë ekskluzivisht produkte të paketuara direkt te konsumatori ose përdoruesi duke patur pikën e magazinimit në lidhje të ngushtë me pikën e shitjes

ADERIMI NË SISTEMIN E KONTROLLIT

Neni 28 Rreg. KE 834/2007

Para se produktet të hyjnë në treg me statusin e produkteve biologjike ose para shndërrimit apo transformimit në produkte biologjike, ose para importimit nga vende të treta dhe para krijimit të kushteve të ruajtjes, operatorët e produkteve biologjike duhet të:

- Njoftojnë aktivitetin e tyre tek autoritetet kompetente dhe tek enti i kontrollit dhe certifikimit të Shtetit Anëtar në të cilin ushtrohet aktiviteti*;
- Ndjekin procedurat e sistemit të kontrollit sikurse referon neni 27

** Në sistemin italian të kontrollit, operatorët mund të zqjedhin një ent kontrolli të akredituar të cilin ata kanë të drejtë ta ndryshojnë në përputhje me kushtet e vendosura nga neni. 2 i Dekretit Ministror 10071/2012*

DOKUMENTACIONI JUSTIFIKUES

Neni 29 i Rreg. KE nr. 834/2007

Organet e kontrollit lëshojnë një dokument mbështetës për operatorët të cilët i nënshtrohen kontrollit të tyre ku pasqyrohet plotësimi i kërkesave të sferës së aktivitetit sikurse janë përcaktuar në rregullore. Dokumenti mbështetës ofron informacion identifikues për operatorin, llojin ose gamën e produkteve dhe periudhën ose afatet e vlefshmërisë.

Operatori duhet pajiset me dokumentin mbështetës dhe me certifikatën e pajtueshmërisë edhe nga furnitorët apo të tretët dhe mund të verifikojë vërtetësinë e dokumentacionit të ofruar prej tyre përmes Regjistrimit Kombëtar të Mbikëqyrjes

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agricoltura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Me Dekretin Ministror 18321/2012, Mipaft (Ministria e Ushqimit Agrikultural, Politikave Pyjore dhe Turizmit) e konsideroi të përshtatshme që dokumentacioni justifikues dhe Certifikata e pajtueshmërisë të jenë të lidhura nën emrin e një operatori (Skeda e operatorit).

Neni. 63 Rreg. KE. 889/08

Ky nen parashikon se nënshtrimi nën regjimin e kontrollit, përpilimi i deklaratës së integruar me aplikimin, është detyrim i operatorit. Konkretisht:

Për t'ju nënshtruar regjimit fillestar të kontrollit, operatori duhet të hartojë dhe azhurnojë një dokument të emërtuar "Deklarata Shtesë Njoftuese" e cila duhet të përmbajë:

- a) një përshkrim të plotë të njësisë dhe/ose njësive dhe/ose veprimtarisë;
- b) të gjitha masat konkrete që janë ndërmarrë në nivelin e njësisë dhe/ose njësive dhe/ose aktivitetit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e prodhimi organik;
- c) masat paraprake që janë ndërmarrë për të zvogëluar rrezikun e kontaminimit nga produkte ose substanca të paautorizuara dhe masat e pastrimit që janë ndërmarrë në vendet e magazinimit përgjatë gjithë zinxhirit të prodhimit të operatorit.

Objektivat e bujqësisë organike

Neni 3 i Rregullores së KE. 834/07

Rregullorja 834.07 ka synim të realizojë disa objektiva:

- a) të krijojë një sistem të qëndrueshëm menaxhimi për bujqësinë që:
 - respekton sistemet dhe ciklet natyrore, mirëmban dhe përmirëson shëndetin e tokës, ujit, bimësisë dhe kafshëve dhe siguron qëndrueshmërinë e ekuilibrit ndërmjet tyre;
 - kontribuon në një nivel të lartë të larmisë biologjike;
 - siguron përdorim të përgjegjshëm të energjisë dhe burimeve natyrore siç janë uji, toka, lënda organike dhe ajri;
- b) synon përfitim të produkteve me cilësi të lartë;
- c) synon prodhimin e një larmie të gjerë ushqimesh dhe produktesh të tjera bujqësore që i përgjigjen kërkesës së konsumatorit për produkte të përfituara me procese që nuk dëmtojnë mjedisin, shëndetin e njeriut, shëndetin e bimëve, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Parimet specifike

Neni 5 i Rregullores KE nr. 834/07:

Parimet specifike të Rreg. 834/07 përcaktohen nga neni 5 i saj sikurse:

- Të mirëmbajë dhe përmirësojë jetën dhe pjellorinë natyrore të tokës,
- Të sigurojë qëndrueshmërinë e tokës dhe të biodiversitetit të saj,
- Të parandalojë dhe luftojë ngjeshjen dhe erozionin e tokës dhe të sigurojë ushqimin e bimëve kryesisht përmes ekosistemit të tokës;
- Të marrë parasysh ekuilibrin ekologjik lokal dhe rajonal kur bëhen zgjedhjet e prodhimit;
- Të riciklojë mbeturinat dhe nënproduktet me origjinë bimore dhe shtazore si faktorë ndihmës prodhimi për të korrat dhe bagëtinë;

Rregullat e përgjithshme të prodhimit (prodhimet paralele)

Neni 11 i Rregullores KE nr. 834/07:

E gjithë ferma duhet të menaxhohet në përputhje me kërkesat e detyrueshme për prodhimin organik. Gjithsesi, një kompani mund të ndahet në njësi të dallueshme ku jo të gjitha operojnë nën prodhimin organik:

- sa i përket kafshëve, kjo vlen për speciet e dallueshme;
- sa i përket bimëve, kjo vlen për varietetet lehtësisht të dallueshme.

Operatori duhet të mirëmbajë tokën, kafshët dhe produktet e përdorura për njësi biologjike ose ato të marra nga njësi të tilla, të ndara nga ato që përdoren për njësitë jo-organike.

Ndarja duhet të dokumentohet siç duhet dhe e plotë.

Përrjashtimi nga ndalimi i kultivimit paralel është i lejueshëm vetëm për rastet e mëposhtme:

- a) në rastin e kulturave shumëvjeçare që kërkojnë një periudhë kultivimi prej të paktën tre vjet dhe kur varietetet nuk janë lehtësisht të dallueshme. Prodhimi i prekur duhet të jetë pjesë e një plani shndërrimi (aprovuar nga Enti i Kontrollit ose autoriteti kompetent) sipas të cilit prodhuesi pajtohet zyrtarisht që konvertimi i pjesës së fundit të zonës së përfshirë në prodhimin organik të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda periudhës pesë vjeçare;
- b) në rastin e zonave të destinuara për kërkime shkencore bujqësore ose mësimdhënies parashikuar nga marrëveshje me autoritete kompetente të Shteteve Anëtare.
- c) në rastin e prodhimit të farës, materialit shumëzues bimor vegjetativ ose transplantues.
- d) në rastin e tokës që përdoret ekskluzivisht për kullotje.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Rregullat e prodhimit bimor

Neni 12 i Rregullores KE. 834/07

Pjelloria dhe aktiviteti biologjik i tokës ruhen dhe përmirësohen përmes rotacionit shumëvjeçar të të korrave, përfshirë bishtajoret e bimë të tjera që përbëjnë plehun e gjelbër, fekondimin me pleh natyral me origjinë shtazore ose me lëndë të tjera organike (mundësisht të kompostuar nga prodhimi organik);

Parandalimi i dëmeve të shkaktuara nga dëmtuesit, sëmundjet dhe barërat e këqija realizohet kryesisht përmes mbrojtjes së armiqve natyrorë që me zgjedhjen e specieve dhe varieteteve, rotacionin e të korrave, teknikave të kultivimit dhe proceset termike;

Shënim: Dekreti Ministror 6793/2018 ndërhyri duke rregulluar dispozitat për zbatimin e rregulloreve KE nr. 834/2007, nr. 889/2008, nr. 1235/2008. Neni 2 përcakton rregullat e përgjithshme për rotacionet dhe të gjithë operatorët e kontrolluar duhet të operojnë në përputhje me to.

Rregullat e prodhimit bimor

Neni 12 i Rregullores KE nr. 834/07

Prodhimi organik i perimeve duhet të përdorë teknikat e përpunimit të tokës dhe praktikat e kultivimit që synojnë ruajtjen ose rritjen e përmbajtjes së substancave organike në tokë, të rrisë qëndrueshmërinë dhe biodiversitetin e saj, si dhe të parandalojë ngjeshjes dhe erozionit e tokës;

- lejohet përdorimi i preparateve biodinamike;
- përdorimi i plehrave dhe përmirësuesve të tokës lejohen vetëm nëse produkte të tilla kanë qenë të autorizuar (Shtojca I e Rregullores së KE. 889/2008);
- nuk lejohet përdorimi i plehrave minerale azotikë;
- të gjitha teknikat e prodhimit të bimëve duhet të shmangin ose kufizojnë në minimum ndotjen e mjedisit;
- në rast të përcaktimit serioz të rrezikut për një kulturë, lejohet përdorimi i produkteve të autorizuar për mbrojtjen e bimëve

(Parashikuar në Shtojcën II të Rregullores së KE. 889/2008)

Rregullat e prodhimit bimor (bimët e egra)

Neni 12 i Rregullores KE nr. 834/07

Mbledhja e bimëve të egra dhe pjesëve të tyre, të cilat rriten natyrshëm në zona natyrore, pyje apo zona bujqësore, konsiderohet një metodë e prodhimit organik por me kusht që:

- zonat nuk i janë nënshtruar trajtimeve me substanca jo-organike prej të paktën një periudhe tre vjeçare nga fillimi i mbledhjes së tyre
- mbledhja nuk komprometon ekuilibrin e habitatit natyror të specieve në zonën e mbledhjes.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Plehrat dhe ndryshuesit e lejuar

Neni 3 i Rregullores KE nr. 889/2008

Në rastet kur sasi të e parashikuara nga neni 12 i Rregullores KE nr. 834/2007 nuk mundësojnë plotësimin e nevojave nga ushqyes bimorë, në kontekstin e prodhimit organik, lejohet të përdoren vetëm plehra dhe përmirësuesit e tokës referuar në aneksin I të kësaj rregulloreje dhe vetëm brenda kufijve të nevojshëm të parashikuar.

Operatorët duhet të mbajnë dokumentacion mbështetës arsyetues që vërteton nevojën për përdorimin e produkteve të tilla.

Kujdes: Edhe nëse disa produkte janë të autorizuar, kjo nuk do të thotë se ato mund të përdoren. Disa plehra dhe përmirësues të tokës, të parashikuara në Aneksin I, mund të përdoren vetëm nëpërmjet disa metodave të aplikimit, për shembull:

Plehu dhe plehrat e thata – janë të ndaluara të përdoren ato që sigurohen nga feramat industriale

Plehu acidik – ka një përdorim të kufizuar në hortikulturë

Për informacion të detajuar rreth plehrave dhe ushqyesve mund ti referoheni Regjistrin të plehrave:
<http://www.sian.it/vismiko/jsp/indexConsultazione.do>

Lufta kundër parazitëve, sëmundjeve dhe barërave të këqija

Neni 5 Rregullores KE nr. 889/08

Në rastet kur masat e parashikuara nga Neni 12 të Rreg. KE nr. 834/2007 nuk sigurojnë mbrojtjen e duhur të bimëve kundër dëmtuesve dhe sëmundjeve, në kontekstin e prodhimit organik është e lejueshme të përdoren vetëm produktet e renditura në Shtojcën II të kësaj rregulloreje dhe vetëm në sasi të e nevojshme.

Operatorët janë të detyruar të mbajnë dokumentacion mbështetës dhe arsyetues që vërteton nevojën e përdorimit të këtyre produkteve

Vëmendje: Edhe nëse disa produkte janë të autorizuar kjo nuk do të thotë se mund të përdoren.

Disa mjete mbrojtëse, të parashikuara në Shtojcën II, mund të përdoren vetëm në mënyra të specifikuar si për shembull:

Hidroksid kalciumi - Fungicid: vetëm në pemët frutore, përfshirë kopshtet

Pyrethroid (vetëm deltamethrin ose lambdacialothrin) - Insekticid: vetëm në kurthe të kombinuara me substanca specifike tërheqëse

Vëmendje: Në përputhje me Rregulloren KE 396/2005 dhe ndryshimet pasuese, jo të gjithë produktet pesticide janë të regjistruara për kultura specifike.

Inspektorëve të Kontrollit u kërkohet të kontrollojnë nëse produktet e përdorura janë regjistruar për kulturat specifike me trajtim të veçantë.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Referimi bëhet me bazat e të dhënave të pesticideve të aksesueshme për të gjithë si vijon:

<http://www.sian.it/biofito/accessControl.do>

http://www.icps.it/pestidoc/icps_template.asp

<http://www.winbdf.it>

http://www.feder.bio/Mezzi_tecnici.php

Rregullat e konvertimit

Neni 36 i Rreg. KE nr. 889/2008

Pse merren parasysh rregullat e konvertimit në prodhimin organik për bimët dhe produktet bimore?
Rregullat e prodhimit organik për bimët dhe produktet bimore në parcela duhet të jenë aplikuar në periudha konvertimi të paktën:

- dy vjet para mbjelljes ose transplantimit për të korrat barishtore;
- dy vjet para përdorimit të tyre në rastin e kullotave ose livadheve të përhershëm;
- të paktën tre vjet para korrjes së parë të prodhimit organik, në rastin e kulturave shumëvjeçare të ndryshme nga foragjeret (fruta, pemë ulliri, etj.)

Përdorimi i farave ose materialit shumues bimor jo-organik

Neni 45 i Rreg. KE 889/2008

Në rast të mos disponueshmërisë të farave apo materialit shumues bimor në tregun organik (kushtet e referuara në Nenin 2, paragrafi 2, pika b e Rregullores së KE nr. 834/2007):

- a) mund të përdoren si material shumues farat dhe materiali i shumimit bimor që vjen nga një njësi e prodhimit në fazën e konvertimit në bujqësi organike;
- b) në rast se shkronja a) nuk është e zbatueshme, atëherë si material shumues për prodhimin organik, mund të autorizohet përdorimi i farave ose materialit shumues bimor jo-biologjik.

Me Dekretin Ministror nr. 15130 të 27 Shkurtit 2017 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 95 të 24 Prillit 2017 u themelua:

Baza e të dhënave të farërave BIO (BDS).

Baza e të dhënave të farërave BIO është një sistem i automatizuar që vihet në dispozicion nga Sistemi i Informacionit Biologjik dhe që zgjidh funksione të ndryshme.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Prioritetet e Bazës së të Dhënave të Farërave

1. Përmban listën e specieve dhe varieteteve të farërave apo të materialit shumues bimor i përfituar me metodën e prodhimit organik, i disponueshëm në tregun kombëtar apo ofruar nga furnitorë të certifikuar;
2. Përcakton listat e ekuivalencës së varieteteve për speciet e sigurta, në mënyrë që të garantohet përdorimi preferencial i farave organike dhe i materialit shumues bimor duke zvogëluar lejimin e përjashtimeve;
3. Thjeshton procedurën e lejimit të përjashtimeve në përdorimin e farave, zhardhokëve të farës së patates dhe materialit shumues bimor që nuk përfitohen me metodën e prodhimi organik

BIO ËSHTË ÇERTIFIKIMI I METODËS DHE JO I PRODUKTIT

Certifikimi "BIO" është certifikimi i një procesi referuar plotësisht të kërkesave të pajtueshmërisë së standardit të certifikimit përgjatë gjithë procesit të prodhimit apo përgatitjes (p.sh. nisur nga fekondimi apo shtesat e lejuara);

Certifikimi "DO" (në zbatim të Rregullores së BE 1151/2012) nënkupton certifikimin e produktit përsa i përket pajtueshmërisë së kërkesave që kanë të bëjnë me karakteristikat e produktit përfundimtar; parashikon certifikimin e të gjitha pjesëve në shitje të kontrolluara analitikiisht (***p.sh. për vajin: kufijtë e acidit oleik dhe përmbajtjen sasiore të peroksideve për litër***);

Qëllimi tërësor i certifikimit të produkteve, i proceseve apo i shërbimeve konsiston në rrënjosjen e besimit tek të gjitha palët e interesuara që një produkt, proces apo shërbim i certifikuar i kënaq plotësisht kërkesat e specifikuar për të.

Vlera e certifikimit është shkalla e besimit dhe siguria që i transmetohet një Pale të Tretë përmes një sjelljeje të:

PAANSHME
dhe të
KUALIFIKUAR

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit **“Suolo e Salute”**
për Rajonin e Campania-s
Workshop: **“Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV”**
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

ISO 17065:2012

Standard referimi për akreditimin e Organeve të Certifikimit (OeC)

ISO 17065:2012

Fusha e aplikimit:

Standardi ndërkombëtar ISO 17065:2012 përmban kërkesat dhe kushtet referuar kompetencës, funksionimit konsistent dhe të paanshëm të enteve certifikuese të produkteve, proceseve dhe shërbimeve

ISO 17065:2012

"Palët e interesuara" (kryesisht por jo të kufizuara vetëm tek to) të cilët janë të përfshira në sferën e certifikimit dhe që janë të interesuara për vlerën e shtuar nga kjo përfshirje janë:

- Klientët e organeve dhe enteve të certifikimit;
- Klientët e operatorëve, produktet e të cilëve janë të certifikuar;
- Ekspertë të vlerësimit të përputhshmërisë;
- Autoritetet Kompetente;
- Organizata joqeveritare;
- Konsumatorët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit;
- Shoqatat tregtare (prodhuesit, përpunuesit).

ISO 17065:2012

Paanshmëria

Organet certifikuese duhet të:

- garantojnë që tërësia e aktiviteteve të tyre të certifikimit të kryhet në mënyrë të paanshme;
- të jenë përgjegjës për paanshinë e gjithë aktiviteteve të tyre të certifikimit dhe nuk duhet të lejojnë presion tregtar, kompromis ekonomik, financiar ose çdo lloj tjetër kompromisi mbi paanshmërinë e tyre;
- I gjithë personeli i organit të certifikimit (i brendshëm dhe i jashtëm) apo anëtarët e komiteteve, të cilat mund të ndikojnë në aktivitetet e certifikimit, duhet të udhëhiqen nga paanshmëria në veprimet e tyre

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

ISO 17065:2012

Procesi i certifikimit makro

Procesi i certifikimit makro përbëhet nga disa procese kryesore:

1. **Shqyrtimi i aplikimit** (klauzola 7.3 ISO 17065: 2012): procesi i shqyrtimit të informacionit që përmban aplikimi nga ana e Organit të Certifikimit për të verifikuar disponueshmërinë e mjeteve, mekanizmave dhe aftësive të aplikantit për të kompletuar gjithë procesin e certifikimit.
2. **Vlerësimi** (klauzola 7.4 ISO 17065: 2012): vlerësimi i proceseve që mat shkallën në të cilën plotësohen kërkesat e certifikimit, i cili duhet të jetë i dokumentuar dhe i bazuar në prova objektive.
3. **Rishikimi** (klauzola 7.5 ISO 17065: 2012): rivlerësimi i shqyrtimit dhe i rezultateve të vlerësimit.
4. **Vendimi mbi certifikimin** (klauzola 7.6 ISO 17065: 2012): Lëshimi i Certifikatave apo Certifikatave provizore bazuar në rishikimin e vlerësimit

STATUSI JURIDIK I ORGANEVE TË KONTROLLIT

Organet e kontrollit janë ente private të cilave ju delegohet fuqia e kontrollit nëpërmjet një akti administrativ nga Autoriteti Publik.

Ata janë operatorët e një shërbimi/shërbimeve për nevoja publike

«... Staf i organeve të kontrollit është në krye të shërbimit publik gjatë kryerjes së veprimtarisë së kontrollit në përputhje me nenin 358 të Kodit Penal »

Dekreti Legjislativ 23 Shkurt 2018, n. 20 (neni 4 paragrafi 9)

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021



CERTIFIÉ



AGRICULTURE
BIOLOGIQUE



AGRICULTURE
BIOLOGIQUE

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “Suolo e Salute”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

AKTIVITETI I KONTROLLIT

Vizitat e kontrollit

Neni 65 i Rregullores KE nr. 889/08

Organi i inspektimit duhet të kryejë të paktën një herë në vit një inspektim fizik të të gjithë operatorëve. Organi i kontrollit gjithashtu duhet të mbledhë kampionet (mostrat) që analizohen për të identifikuar praninë e përbërësve të paautorizuar në prodhimin organik, për të verifikuar përputhjen e teknikave të prodhimit me standardet e prodhimi organik ose zbulimin e ndonjë ndotjeje të pranishme nga produktet e paautorizuara në prodhimi organik.

Vizitat e kontrollit

Neni 65 i Rregullores KE nr. 889/08

Kontrolli synon të sigurojë pajtueshmërinë e produkteve ushqimore që ofrohen në rang komunitar dhe kombëtar dhe zbatohet gjatë të gjitha fazave të procesit të prodhimit, duke iu referuar llojit të veprimtarisë që i nënshtrohet kontrollit.

Kontrollet mbi aktivitetet e ndërmarrjes ndahen në:

- Kontrolli i hyrjes** (hyrja e Operatorit në sistemin e kontrollit biologjik): inspektimi përfshin të gjitha aktivitetet e kryera nga operatori të krahasuara me periudhën para aplikimit biologjik, me qëllim përcaktimin e përshtatshmërisë së operatorit ndaj regjimit të Kontrollit KE për prodhimin organik (mund të kryhet në disa faza të përkohshme);
- Kontrolli i zakonshëm vjetor** (me ose pa njoftim paraprak): Inspektimi i planifikuar që përfshin të gjitha aktivitetet e kryera nga operatori me qëllim përcaktimin e mirëmbajtjes së përshtatshmërisë së operatorit në respektimin e Regjimit të kontrollit KE të prodhimit organik (mund të kryhet në momente të ndryshme). Asnjë komunikim paraprak nuk duhet ti sigurohet operatorit në rastin e kontrolleve pa lajmërim;
- Kontrolli shtesë** (me ose pa njoftim paraprak): Inspektimi i planifikuar i kryer në bazë të vlerësimit të rrezikut shtesë rezultat i kontrollit të zakonshëm vjetor. Asnjë komunikim paraprak nuk duhet t'i sigurohet operatorit në rastin e kontrollit pa lajmërim;
- Inspektim i jashtëzakonshëm** (me ose pa njoftim paraprak): ky është një inspektim i kryer përveç inspektimeve të planifikuara referuar në shkronjat b) dhe c) i cili gjithashtu mbulon pjesërisht aktivitetet e kryera nga operatori në proporcion me objektivin specifik të kontrollit (p.sh. verifikimi i efektivitetit të një veprimi korigjues, plotësimin e kërkesave apo specifikimeve të autoriteteve kompetente, pas raportimeve / dyshimeve të mosrespektimit si edhe kontrollet e kërkuara nga planet e përforcuara të mbikëqyrjes).

Asnjë komunikim paraprak nuk duhet t'i sigurohet operatorit në rastin e kontrolleve të pa paralajmëruara.

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit “**Suolo e Salute**”
për Rajonin e Campania-s
Workshop: “**Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV**”
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

Vizitat e kontrollit

Neni 65 i Rregullores KE nr. 889/08

Numri i kampioneve (mostrave) që enti i kontrollit duhet të marrë dhe analizojë çdo vit korrespondon me të paktën 5% të numrit të operatorëve që i nënshtrohen kontrollit të tij.

Përzgjedhja e operatorëve të cilëve ju merren mostrat e kontrollit bëhet në bazë të vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut për mosrespektim të rregullave të prodhimi organik. Ky vlerësim merr parasysh të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes.

Shembull: Kompanitë me rrezik të lartë: 100% e kampionuar, minimumi 3 vizita të pa lajmëruara në vit.

Programi vjetor i kontrollit

Programi vjetor i kontrollit planifikohet dhe hartohet në bazë të faktorit të rrezikut që rezulton nga verifikimi i kompanisë.

Për të vlerësuar në mënyrë uniforme dhe sistematike rrezikun që Operatori mund të shesë produkte jo në përputhje me rregullat për prodhimin organik merren në konsideratë faktorët e rrezikut të parashikuara nga Rregullorja Teknike RT16 Rev. 05 e dt. 5/11/2018. (Kultura e Praktikuar, Metodat e miratuara të prodhimit, Sipërfaqja e prodhimit, Madhësia e fermës për zooteknikë organike, Qarkullimi organik për aktivitetet përgatitore)

Prezantim nga Ferruccio d'Angelo, Drejtues Rajonal i Entit të Kontrollit dhe Certifikimit **“Suolo e Salute”**
për Rajonin e Campania-s
Workshop: **“Agrikultura Biologjike-Bashkimi Evropian për NMV”**
Organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqaten e Kultivuesve Italianë (AIC)
Tiranë, 20 prill 2021

AKTIVITETI I KONTROLLIT

Praktika e Entit të Certifikimit **“Suolo & Salute”** për aktivitetin e kontrollit

Në planifikimin e kontrolleve dhe marrjes e mostrave, **“Suolo & Salute”** konsideron 3 vlera rrezikshmërie që pasqyrohen në frekuencën minimale vjetore të inspektimeve dhe marrjes së kampioneve detajuar si vijon:

Faktori i rrezikut të sipërmarrjes	Frekuenca minimale vjetore e inspektimeve dhe marrjes së kampioneve
Rrezik i ulët	Një kontroll rutinë vjetor
Rrezik mesatar	Një kontroll rutinë vjetor dhe një kontroll shtesë kryesisht pa lajmërim paraprak; kampionet për analizë merren mbi të paktën 15 % të objektit të inspektimit dhe në çdo rast sasia e tyre duhet të jetë jo më pak ose e barabartë me rrënjën katrore të tërësisë së objektit të inspektimit
Rrezik i lartë	Një kontroll rutinë vjetor dhe të paktën 2 kontrolle shtesë pa lajmërim paraprak; kampionet për analizë merren mbi 100 % të objektit të inspektimit.

Në rast konstatimi të mosrespektimit të dispozitave evropiane apo kombëtare të parashikuara, si edhe të kuadrit ligjor rajonal në fushën e bujqësisë organike, Entet e Certifikimit duhet të zbatojnë listën e "mos përputhjeve" të raportuara në Shtojcën I të Dekretit Ministror 15962/2013 në veprimtarinë e kontrollit të tyre.

Jo-konformitetet dallohen sipas shkallës së ndikimit/rëndësisë së mosrespektimit, llojet e parregullsive dhe shkeljeve, dhe përfshijnë përshtatjen e masave respektive nga Enti i Kontrollit të cilit i nënshtrohen këta operatorë.

Në Fletoren Zyrtare - Seria e Përgjithshme-nr. 67 të 21 Marsit, u publikua Dekreti Legjislativ 23 Shkurt 2018, n. 20, i cili përmban dispozitat, rregulloret dhe sanksionet për prodhimin bujqësor dhe agro-shqimor me metodën biologjike.

Për herë të parë prezantohet në sektorin e bujqësisë organike një sistem sanksionimi i karakterit administrativ, me parashikimin e llojeve të kundërvajtjeve si për subjektet operative ashtu edhe për subjektet e kontrollit që gëzojnë kompetencën e vendim marrjes brenda organeve të autorizuara të kontrollit.

Dekreti përmban tre nene (8, 10 dhe 11) që parashikojnë masa dhe sanksione penale nga klauzola «Nëse nuk përbën fakt krimi», në rast se një sjellje e specifikuar ndodh, ajo konsiderohet njëkohësisht vepër penale dhe administrative.